

Akti i themelimit

të

shoqërisë

“FIRE GUARD”

shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë, me vullnetin tonë të lirë:

Z. Altin Idrizi i datëlindjes **12/04/1975**, lindur në Muçan dhe banues në Elbasan me kartë identiteti nr. **037455207**, nr personal **H50412012P**,

Z. Leonidha Haxhinikolla i datëlindjes **16/09/1982**, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, me kartë identiteti nr. **038031561**, nr. personal **I20916065P**,

Z. Genci Rami i datëlindjes **13/04/1982**, lindur në Cërrik dhe banues në Elbasan, me kartë identiteti nr. **033819310**, nr. personal **I20413088A**

Neni 1

Formimi

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “FIRE GUARD” shpk. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe të statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.


Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë tregtare private “FIRE GUARD” shpk do të jetë në adresën **Lagja 5 Maji, Rruga Ibrahim Dinci, Elbasan në pasurinë Nr. 20/116-N.11.-2** e regjistruar në regjistrin hipotekor **8525-247 date 09.07.2018**. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e: Tregtim, montim dhe çertifikim të mjeteve dhe sistemeve të shuarjes së zjarrit. Kompletim të ambienteve të ndryshme me fikse zjarri, sistem hidrik zjarrfikës të jashtëm dhe të brendshëm, sistem sprinkler, sisteme automatike shuarës, buton alarm zjarri, sinjalizues zanor dhe pamor, dyer anti panik dhe anti zjarr, gjithë llojet e detektorëve që janë në funksion të parandalimit të zjarreve të mundshëm në objekte të ndryshme, sinjalistikë treguese fosforeshente, reflektuese dhe me ndriçim për mjetet dhe sistemet e mbrojtjes nga zjarri, rrugët e evakuimit dhe mjete të tjera në raste emergjencash. Kolaudim, rimbushje dhe revizion të fikseve të zjarrit. Kontroll fizik periodik të fikseve të zjarrit, hidranteve zjarrfikës, sistemeve të diktim-sinjalizimit, dyerve anti panik dhe të gjithë aksesorëve të nevojshëm sipas normave dhe standarteve Europiane. Inspektimin e vendit të ngjarjes në objektet ku ka rënë zjarri, hartimi i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rëna, hartimi dhe përgatitja e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të ndërtesave të çdo lloji, përgatitja e planeve të evakuimit, përgatitja e dokumentacionit për marrjen e çertifikatës së zjarrit, trajnime të skuadrave të emergjencave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, trajnim i personave në objekte shtetërore dhe private në lidhje me mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin. Çertifikim për mbrojtjen nga zjarri të personave dhe objekteve të ndryshëm. Kolaudim objektesh për masat e marra për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi. Çertifikim i sistemeve të ndryshme të mbrojtjes nga zjarri. Dhënie të vërtetimeve të ndryshme të përputhshmërisë me projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi si edhe pajisjet/instalimet e mbrojtjes nga zjarri. Projekte Alumini dhe PVC plastike. Import-eksport i produkteve të ndryshme të gatshme dhe gjysëm të gatshme, të përpunuara dhe të papërpunuara, aksesorëve që do të shërbejnë dhe çdo lloj tjetër produkti, tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave të përpunuara ose të papërpunuara si dhe të importuara sipas regjimit doganor të përpunimit aktiv ose pasiv si dhe të importit përfundimtar, shitje, këmbime etj.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të papërcaktuar (më shumë se 10 vjet). Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (një qindë mijë) lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku themelues **Altin Idrizi** zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 40.000 (dyzetë mijë) lekë që përbën 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b. Ortaku themelues **Leonidha Haxhinikolla** zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 30.000 (tridhjetë mijë) lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c. Ortaku themelues **Genci Rami** zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 30.000 (tridhjetë mijë) lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Neni 6

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj Z. Altin Idrizi për një periudhë 5-vjecare. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese, nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 8

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Kanë të drejtë të caktojnë financierë, likuidatorë për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për krijimin e Shoqërive tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 (dy) kopje, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “FIRE GUARD” shpk. Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë FIRE GUARD shpk

Altin Idrizi

Leonidha Haxhinikolla

Genci Rami